

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5580
E mërkurë, 19 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Italia konfirmon përkrahjen për FSK-në



Kosova dhe Italia të martën kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit në fushën e trajnimeve, arsimimit dhe edukimit, për shkëmbim të përvojave në rrugën e integritimeve euroatlantike | FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

OPOZITA KËRKON SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE F. 3

VESELI PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS AMBASADORIN AMERIKAN DELAWIE F. 6

KËRKOHET EDHE MË TUTJE PËRKRAHJA E PARLAMENTIT EVROPIAN PËR VIZAT F. 6



EKONOMI

TË HYRAT FINANCIARE PËR MUAJIN GUSHT NË TELEKOM ARRITËN MBI 8 MILIONË EURO F. 9

MINISTRI REÇICA OFRON PËRKRAHJE PËR KOMITETIN E GRAVE TË VERBRA F. 9

KULTURË

JETA NË RRUGËTIM E HAKI MORINËS F. 11

Lulëzim ETEMAJ

SPORT

ERZA MUND T'I SJELLË KOSOVËS MEDALJE OLIMPIKE F. 13

GASHI, NOTARËVE: DO TË NDËRTOJMË PISHINA F. 13

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI LAJÇI | FAQE 4-5

Tërheqja e LDK-së nga protesta, taktikë për shkaqe elektorale



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka vlerësuar se çështja e Kosovës është në rrezik për shkak të tentimeve për të bërë pazare të ndryshme në tavolinën e bisedimeve me Serbinë. Ai ka thënë se trendi i këtyre zhvillimeve politike e do edhe një përgjigje nga

qytetarët pasi, siç thotë ai, institucionet nuk po e kryejnë punën e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka deklaruar se ndalja e trendëve negativë në dialogun me Serbinë mund të bëhet përmes protestave. Ai u ka bërë thirrje qyte-

tarëve ta përkrahin protestën e 29 shtatorit të thirrur nga ky subjekt politik. Ndërkaq duke komentuar mospjesëmarrjen e LDK-së në këtë protestë dhe mosbashkëpunimin me Vetëvendosjen, Lajçi ka thënë se kjo është çështje taktike e LDK-së për elektorat

Publikimi i të dhënave personale të veteranëve, në kundërshtim me ligjin

Shoqëria civile, njohësit e sistemit të drejtësisë dhe OVLUÇK-ja kanë kritikuar për publikimin e listave me të dhëna personale të veteranëve që dyshohen të jenë të rreme. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj-ja) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD-ja) kanë vlerësuar se kjo paraqet shkelje flagrante të të drejtave të njeriut të garantuar me norma vendore dhe ndërkombëtare. Sipas tyre, në këtë shkelje përgjegjëse është edhe Prokuroria e Shtetit | FAQE 7



Thaçi: Marrëveshja Kosovë - Serbi sjell stabilitet rajonal

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Tahiri: Vonesa në miratimin e ligjeve kundër korrupsionit, amnisti për krimin

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abeldar Tahiri, ka pritur të martën në takim drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, me të cilin kanë diskutuar për pakon e ligjeve kundër korrupsionit. Ministri Tahiri ka kërkuar bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë për tejkalimin e barrierave ditore, në mënyrë që të për-

mirësohen politikat publike që mundësojnë efikasitet më të madh në sundimin e ligjit. "Është shumë me rëndësi që Projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe ai për mbrojtjen e sinjalizuesve të miratohen nga Kuvendi sa më parë që është e mundur. Vetëm përmes konfiskimit të pasurisë së fituar nga

aktiviteti kriminal, ne si shoqëri do arrijmë të ndërtojmë një Kosovë në të cilën krimi i organizuar, korrupsioni dhe abuzimi nuk do të gjejnë vend", ka thënë ministri Tahiri.

Sipas ministrit Tahiri, deputetët, liderët institucionalë dhe ata partiakë duhet t'i përmbushin pritshmëritë e qytetarëve për konstruktivitet në çështjet jetike që

ndikojnë në sundimin e ligjit. "Dinamika e zhvillimit institucional dhe shtetëror është shumë e rëndësishme në këtë kohë kur qytetarët tanë presin konstruktivitet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, liderët institucionalë dhe ata partiakë, në çështjet jetike që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Çdo vonesë në miratimin e ligjeve është amnisti për krimin dhe për-



fitimin e paligjshëm. Këtë situatë nuk duhet ta lejojmë dhe kjo është përgjegjësi e të gjithë neve", ka thënë Tahiri.

Ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Italisë, Elisabetta Trenta, ka qëndruar për vizitë në Kosovë

Italia konfirmon përkrahjen për FSK-në

Kosova dhe Italia të martën kanë nënshkruar memorandum të bashkëpunimit në fushën e trajnimeve, arsimimit dhe edukimit, për shkëmbim të përvojave për rrugën e integriteteve euroatlantike. Me këtë rast ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Elisabetta Trenta, është zotuar se shteti i saj do të vazhdojë ta mbështesë FSK-në dhe pjesëtarët e saj me trajnime në fushën e logjistikës



Nënshkruhet memorandum i bashkëpunimit ndërmjet MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Italisë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha dhe ministrja e Mbrojtjes së Italisë, Elisabetta Trenta, në mjesditet e Qeverisë të Republikës së Kosovës të martën kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes

së Republikës së Italisë. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Italisë parasheh bashkëpunimin e dyanshëm në fushën e trajnimeve, arsimimit dhe edukimit, shkëmbimit të përvojave në rrugën e integriteteve euroatlantike etj.

popullit tonë për Ushtrinë italiane, që në kuadër të KFOR-it i ka

shërbyer garantimit të një mjedisi të sigurt për të gjithë dhe ka ndih-

muar për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së", ka thënë Haradinaj.

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Italisë, Elisabetta Trenta. Me ministrin e Mbrojtjes së Italisë presidenti Thaçi ka biseduar për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për forcimin e fqinjësisë së mirë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe për procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosura të Kosovës. "Ju falënderoj për përkrahjen e vazhdueshme që Italia ia ka dhënë dhe po vazhdon t'ia japë Kosovës. Me mbështetjen tuaj dhe të vendeve të tjera të NATO-s, Forca e Sigurisë së Kosovës është bërë forcë shumetnike, profesionale dhe me standarde të NATO-s", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Italisë, Elisabetta Trenta, është zotuar se Italia do të vazhdojë ta mbështesë Forcën e

Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët e saj me trajnime në fushën e logjistikës.

Presidenti Thaçi dhe ministrja italiane, Elisabetta Trenta, kanë biseduar edhe për përkrahjen që do ta marrë Forca e Sigurisë së Kosovës përmes Memorandumit të Bashkëpunimit, që sot është nënshkruar nga të dyja shtetet. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim ministrin italian.

Haradinaj ka thënë se Kosova me vendosmëri po ndjek rrugën euroatlantike si orientim i vetëm i saj. Ai ka treguar se ministrin italian të Mbrojtjes, Elisabetta Trenta, e ka njoftuar për vendimin sovran të Qeverisë së Kosovës për pakon e tri ligjeve për tranzicionin e FSK-së, që buron nga nevoja e pashmangshme e konsolidimit të brendshëm të shtetit. "Ne jemi të gatshëm, nën ombrellën e NATO-s, t'i shërbejmë paqes dhe sigurisë në vend, rajon dhe më gjerë. Ministres Trenta i shpreha falënderimet e

Meta fton shqiptarët në Maqedoni të votojnë pro referendumit

TIRANË, 18 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur në takim kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë, Menduh Thaçi. Presidenti Meta ka vlerësuar qasjen pozitive të Qeverisë së Maqedonisë për reformat gjithëpërfshirëse dhe për kontributin e rëndësishëm të faktorit politik shqiptar në këto procese

jetike. Meta ka nënvizuar se faktori politik shqiptar në Maqedoni ka pasur dhe ka një rol të pazëvendësueshëm në procesin e transformimit të brendshëm social dhe politik, si dhe për integrimet e Maqedonisë në organizatat euroatlantike.

Duke nënvizuar rëndësinë e integritetit të shpejtë evropian të të dy vendeve si dhe të rajonit, presi-

denti Meta ka theksuar se Maqedonia është në një moment tepër të favorshëm dhe optimist pas zgjidhjes së kontestit me Greqinë. Në këtë kontekst, presidenti Meta u ka bërë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të marrin pjesë në referendumin e 30 shtatorit dhe të votojnë pro të ardhmes së sigurt evropiane të shtetit maqedonas.



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbajtur të martën konferencë për medie

Thaçi: Marrëveshja Kosovë - Serbi sjell stabilitet rajonal

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë do të sjellë stabilitet dhe siguri në rajon. Ai ka mohuar zërat se një marrëveshje e tillë, e cila do ta përfshinte korrigjimin e kufirit në mes të dy vendeve, mund ta destabilizojë rajonin. Sipas tij, zërat e tillë që po shpërndajnë frikë dhe panik janë të paargumentueshëm dhe të paqëndrueshëm

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kritikuar zërat që pretendojnë se korrigjimi i kufirit Kosovë - Serbi në kuadër të marrëveshjes përfundimtare do ta destabilizojë rajonin. Në një konferencë për medie ai ka thënë të martën se këta zëra janë të paqëndrueshëm dhe vetëm po mundohen të shpërndajnë mjegull. Sipas shefit të shtetit, frika të tilla janë shpërndarë edhe në prag të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. "Dyshuesit në marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë me lehtësi po përhapin shqetësim dhe fillim të ndarjes etnike. Në çdo rast të arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi do ta ruajmë frymën e multietnicitetit. Janë këto mjegulla që shpërndaheshin edhe në prag të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, prandaj edhe kjo frikë, panik dhe mjegull do të tejkalohet dhe do të tërhiqen të gjitha me arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi", ka thënë Thaçi. Ai ka treguar se është takuar me udhëheqësit e shteteve të rajonit dhe se asnjë shtet i rajonit nuk shqetësohet nga një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nuk ka asnjë panik, frikë, shqetësim te vendet fqinje, në rast se Kosova arrin marrëveshje me Serbinë. Prandaj zërat që pretendojnë të përhapin informata janë të paqëndrueshëm, të paargu-

mentuar dhe në asnjë rrethanë nuk do të merren parasysh", është shprehur ai. Shefi i shtetit ka deklaruar se marrëveshja përfundimtare i siguron Kosovës njohjen formale nga Serbia, bashkëngjiten e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit në territorin e Kosovës si dhe i hap rrugë të sigurt Kosovës drejt anëtarësimit në NATO, Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara. "Dhe nuk do të ketë korrigjim të kufirit përgjatë vijave etnike, nuk do të ketë eksod të popullsisë dhe as efekt domino sa i përket stabilitetit të kësaj ane të Evropës. Po e përsëris edhe një herë, korrigjimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të pavarura të cilat do të njihnin njëra-tjetrën si shtete, do të jetë pjesë përbërëse e demarkacionit të kufirit të gjatë 430 kilometra, kurdo që do të ndodhë marrëveshja paqësore Kosovë - Serbi", ka vlerësuar Thaçi. Ai ka përsëritur edhe një herë se nuk beson se dikush do t'i bëjë presion Serbisë për ta njohur pavarësinë e Kosovës. "E kam obligim t'ju them të vërtetën e plotë nga e cila varet ardhmëria e vendit. Në këtë kontekst mund të them se askush nuk bën të shpresojë në Kosovë, por edhe jashtë, që Aleanca Veriatlantike apo kushdo qoftë do ta detyrojë me forcë Serbinë ta njohë pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, nuk besoj se Këshilli i Evropës do të rrisë sanksione ndaj Serbisë për ta njohur Kosovën", ka thënë ai.

Haradinaj: Korrigjimi i kufirit na kthen mbrapa

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, përsëri ka folur rreth idesë së korrigjimit të kufirit në kuadër të marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Ai ka thënë se korrigjimi i kufirit e kthen Kosovën në të kaluarën. "Unë mendoj se detyra jonë është ta mbrojmë Kushtetutën dhe integritetin territorial. Nuk është e drejtë jona të flasim për territore pa mandate. Jam i bindur që synimi i një marrëveshje për korrigjim të kufijve është kthim prapa. Marrëveshja më e mirë do të ishte të jetë

paqësore, dhe një e tillë të ndodhë për të gjithë popujt e Ballkanit", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë me gazetarë, pas mbledhjes së Qeverisë. Haradinaj në këtë konferencë ka folur edhe për Qeverinë e cila ka dy ushtrues detyre të ministrave. "Ne kemi bërë një lloj konsulte me partnerët. Tash mendojmë që AKR-ja duhet të propozojë një ministër. Kemi shpresuar që ajo të jetë femër. Edhe në MTI shpresoj se Nisma do ta dërgojë një propozim", ka thënë Haradinaj.

Opozita kërkon seancë të jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare



PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Duke pasur parasysh mosfunksionimin normal të Kuvendit të Kosovës, grupi parlamentar i LDK-së, i LV-së, i PSD-së dhe deputetët e pavarur Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda kanë dorëzuar të martën kërkesën me të cilën kërkojnë thirrjen e seancës së jashtëzakonshme në të cilën kërkohet të ratifikohen marrëveshjet ndërkombëtare.

"Gjithashtu, duke ditur se asistencat e BE-së në procesin e integritetit evropian të Republikës së Kosovës, e posaçërisht asistencat për përmirësimin e obligimeve të dala nga MSA-ja, siç janë asistencat që rrjedhin nga ratifikimi i Marrëveshjes së IPA-së që sjell 48 milionë euro për Kosovën, Programi 'Evropa për qytetarët', i cili i mundëson Kosovës qasje në më se 17 programe të BE-së,

si dhe asistencat në platformat mbështetëse të IT-së dhe mbështetja në reformën e politikave për arsim dhe rini që parasheh Programi 'Erasmus +', deputetët e nënshkruar vlerësojnë se ratifikimi i tyre duhet të ndodhë sa më parë. Seanca është kërkuar të mbahet më 20. 9. 2018 në orën 14.00", është bërë me dije në një komunikatë të LDK-së.

Flet për "Epokën e re", Ali Lajçi

Tërheqja e LDK-së nga protesta,



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka vlerësuar se çështja e Kosovës është në rrezik për shkak të tentimeve për të bërë pazare të ndryshme në tavolinën e bisedimeve me Serbinë. Ai ka thënë se trendi i këtyre zhvillimeve politike e do edhe një përgjigje nga qytetarët pasi, siç thotë ai, institucionet nuk po e kryejnë punën e vet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka deklaruar se ndalja e trendëve negativë në dialogun me Serbinë mund të bëhet përmes protestave. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve ta përkrahin protestën e 29 shtatorit të thirrur nga ky subjekt politik. Ndërkaq duke komentuar mospjesëmarrjen e LDK-së në këtë protestë dhemosbashkëpunimin me Vetëvendosjen, Lajçi ka thënë se kjo është çështje taktike e LDK-së për elektorat

për gazetën "Epoka e re", Lajçi ka deklaruar se ndalja e trendëve negativë në dialogun me Serbinë mund të bëhet përmes protestave. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve ta përkrahin protestën e 29 shtatorit të thirrur nga ky subjekt politik meqë, sipas Lajçit, ka mbetur rruga e vetme për t'i sjellë ndryshimet e nevojshme. Lajçi ka folur edhe për tërheqjen e LDK-së nga mundësia e bashkëpunimit opozitar, duke e quajtur taktikë të kësaj partie për shkaqe elektorale

institucioneve është parë se do të ketë krizë të vazhdueshme meqë konstituimi nuk u bë në baza programore, por në baza grupore dhe partiake. Denigrimi institucional po shkon drejt rritjes dhe kemi menaxhim të dobët të vendit. Institucionet po degradohen dhe në tavolinën e bisedimeve po nxirren tema të rrezikshme. Trendi i këtyre zhvillimeve politike e do edhe një përgjigje nga qytetarët sepse institucionet nuk po e kryejnë punën e vet. Nuk funksionojnë as mocionet, as vendimet dhe as rezolutat. Ka ardhur puna që edhe rruga të jetë një prej mundësive për ndryshime në nivel të Kosovës. Ndryshimet janë më së të nevojshme dhe është koha e tyre. Çështja e Kosovës është në rrezik për shkak të tentimeve për të bërë pazare të ndryshme dhe aktualisht po nxirren gjera të rrezik-

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ali Lajçi, ka bërë me dije të martën se kjo parti do t'i përkrahë në Kuvend tri projektligjet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ai i ka bërë thirrje Qeverisë të jetë e vendosur për t'i dhënë FSK-së karakter ushtarak. Lajçi ka folur edhe për çështjen e veteranëve të UÇK-së, duke thënë se kaosi i krijuar për këtë kategori mund të zgjidhet përmes ndryshimit të ligjit. Sipas tij, në këtë çështje ka gisht edhe politika.

Duke folur për fazën finale të

dialogut Kosovë - Serbi, deputeti Lajçi ka vlerësuar se çështja e Kosovës është në rrezik për shkak të tentimeve për të bërë pazare të ndryshme në tavolinën e bisedimeve me Serbinë. Ai ka thënë se trendi i këtyre zhvillimeve politike e do edhe një përgjigje nga qytetarët pasi, siç thotë ai, institucionet nuk po e kryejnë punën e vet. Në këtë intervistë dhënë

"Epoka e re": Z. Lajçi, Lëvizja Vetëvendosje ka marrë vendim t'u kthehet sërish protestave për t'i kundërshtuar zhvillimet politike në vend. Protesta e radhës pritet të mbahet më 29 shtator. Prisni mbështetje qytetare për ta arritur qëllimin final?

Lajçi: Që nga konstituimi i

taktikë për shkaqe elektorale



Fillimisht Serbia duhet ta njohë Kosovën si shtet, pastaj të bisedohet. Nuk mund të vazhdohet kështu sepse vetëm do të kemi zgjatje të krizës. Njohja e pavarësisë dhe forçimi i sovranitetit të Kosovës duhet të jenë primare. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, presim mbështetje të qytetarëve në protestën e 29 shtatorit.

"Epoka e re": Do të mund t'i mbushni me qytetarë sheshet e kryeqytetit tash që Vetëvendosja nuk e ka fuqinë politike siç e ka pasur në të kaluarën si dhe opozita nuk është e bashkuar siç ka qenë?

Lajçi: Protestën nuk e kemi thirrur në baza partiake. Bazë do të jetë pjesëmarrja e qytetarëve pavarësisht prej përkatësisë partiake të tyre për shkak se kriza aktuale po e rëndon gjendjen e qytetarëve.

"Epoka e re": Por kjo protestë nuk do ta ketë as mbështetjen e PSD-së dhe as të LDK-së.

Lajçi: Pavarësisht prej deklarimeve të partive politike, qytetarët do të duhej ta mbështesnin protestën. Qytetarët duhet të mendojnë për fatin e vet pavarësisht kush e organizon protestën.

"Epoka e re": Ndonëse u paralajmërua një mobilizim në mes të partive opozitare për ta rrëzuar Qeverinë, respektivisht për ta çuar vendin në zgjedhje të reja, një gjë e tillë si duket do të jetë e pamundur pas kundërshtimit që ka bërë LDK-ja si partia më e madhe në vend. Si e shihni këtë tërheqje të LDK-së?

Lajçi: Është çështje taktike e LDK-së për elektorat. Mbase LDK-ja nuk do të duhej të

mendonte një gjë të tillë, por për interesin e vendit. Është çështje taktike e LDK-së për shkaqe elektorale. Sidoqoftë, qytetarët nuk do të duhet të bazohen në këtë, por të marrin pjesë në protestë. Do të ishte mirë që LDK-ja të deklarohej për dhe ta thërriste edhe elektoratin e vet në protestë, sepse efekti do të ishte më i mirë.

"Epoka e re": Si mund ta prisni mbështetjen e LDK-së përderisa lideri i kësaj partie e bëri të qartë se LDK-ja nuk do t'i shkojë pas Vetëvendosjes dhe nuk do të jetë pjesë e protestave. Me këtë përfundimisht shuhen shpresat e një bashkëpunimi LV - LDK?

Lajçi: Sigurisht se bashkëpunim do të ketë, por intensiteti i bashkëpunimeve do të varet shumë prej kohës dhe prej çasteve politike. Tekfundit, ne llogarisim në qytetarët, pse jo edhe në elektoratin e LDK-së.

"Epoka e re": Por ata po refuzojnë të bashkëpunojnë me LV-në.

Lajçi: Është çështje e taktikave të LDK-së. Pavarësisht prej deklaratave dhe zhvillimeve politike, presim bashkëpunim.

"Epoka e re": Si e komentoni iniciativën e Qeverisë për miratimin e projektligjeve për transformimin e FSK-së përmes të cilave parashihet që FSK-ja të marrë kompetenca dhe detyra të reja? Do t'i përkrahë Vetëvendosja këto projektligje në Kuvend?

Lajçi: Këto kanë qenë iniciativa të kahershme, por është problem të ndodhë ky proces. Në parim i përkrahim synimet e tilla por, si duket, edhe kjo iniciativë më shumë është elek-

torale dhe taktikë politike sesa që është përnjëmend. Pa asnjë dilemë do t'i votojmë nëse na i sjellin në Kuvend. U bëjmë thirrje t'i dërgojnë në Kuvend dhe të mos bëjnë politikë me një çështje shumë të rëndësishme siç është themelimi i ushtrisë. Kjo duhet të bëhet, madje po bëhet me vonesë, por Kushtetuta është ai laku në fyt që i pengon proceset dhe e pengon sovranizimin e Kosovës. Prandaj duhen bërë ndryshimet kushtetuese që çojnë drejt sovranitetit dhe jo kthimit prapa. Ushtria duhet të bëhet përmes Kushtetutës në mënyrë që të marrë karakter dhe mision ushtarak. Nuk duhet të eksperimentohet me ushtrinë. Praktikrat e deritashme kanë treguar se iniciativat e tilla janë bërë për qëllime politike, prandaj kemi drojë se edhe tani po bëhet për qëllime politike dhe elektorale. Të shpresojmë që kjo iniciativë të jetë e vërtetë dhe FSK-ja të bëhet forcë ushtarakë.

"Epoka e re": Kjo iniciativë mendoni se është bërë në koordinim me partnerët ndërkombëtarë të cilët më herët e kanë kundërshtuar transformimin e FSK-së përmes ligjit?

Lajçi: Transformimi i FSK-së do të duhej të kryhej më herët. Me Kushtetutë FSK-ja merr mision ushtarak, kurse me ligj disa detyra dhe kompetenca, por nuk e çon deri në fund misionin. Qeveria duhet të jetë e vendosur që FSK-së t'i japë karakter ushtarak. Ushtria e Kosovës e balancon paqen në rajon, krijon kushte të reja dhe Kosova është më e sigurt si shtet.

"Epoka e re": Ju po kërkonit që transformimi i FSK-së të bëhet

përmes ndryshimeve kushtetuese, që aktualisht nuk mund të ndodhë.

Lajçi: Ne jemi që FSK-ja të marrë mision ushtarak. Cilido version që vjen në Kuvend, do ta votojmë.

"Epoka e re": Z. Lajçi, këto ditë në opinion ka bërë bujë publikimi i listave të prokurorisë me veteranët e rrejshëm. Në mesin e tyre aty janë shtuar edhe emrat e disa prej veteranëve të vërtetë. Si e shihni zgjedhjen e kësaj çështje, përmes drejtësisë apo politikës?

Lajçi: Është e vështirë zgjidhja e kësaj çështje sepse është ngatërruar edhe politika. Krizë në këtë proces ka krijuar edhe ligji, prandaj do të duhej të ndryshohet Ligji për veteranët. Ligji për veteranët e UÇK-së duhet të rishikohet në mënyrë që të bëhet një ligj më adekuat. Pas kësaj gjendje edhe mund të bëhet një ligj më adekuat i cili mund të jetë më funksional për rrethanat e krijuara. Është problematizuar shumë kjo çështje, madje me veprimet e fundit është prishur imazhi edhe i institucioneve dhe i veteranëve të UÇK-së.

"Epoka e re": Konsideroni se politika ka ndërhyrë në rastin e fundit, duke i bërë pjesë të listës së veteranëve të rrejshëm edhe disa emra të veteranëve të vërtetë?

Lajçi: Po, sigurisht, sepse po shihet se ka ngatërresa. Lista e publikuar shihet se ka ndikime nga politika, ani pse thirret në drejtësi dhe prokurori. Është banalizuar çështja e veteranëve, prandaj duhet të rishikohet ligji pa u dëmtuar veteranët e vërtetë.

shme. Duhet të reagojmë për ndaljen e këtyre trendëve negativë në dialogun me Serbinë.

Më 29 shtator mbahet protesta e Vetëvendosjes

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka bërë me dije të martën se më 29 shtator në orën 14:00 në Prishtinë do të mbahet protesta e cila do të organizohet nga kjo lëvizje. Ai i ka ftuar të gjithë qytetarët pa dallim moshe dhe gjinie që t'i bashkohen kësaj proteste. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se kjo protestë do të jetë paqësore. Kurti ka thënë se kjo protestë do

të mbahet për shkak të gjendjes politike në vend dhe për shkak të veprimeve të fundit të presidentit Hashim Thaçi në raport me dialogun me Serbinë. Ai ka kërkuar të ndalen aventurat e Thaçit në raport me këtë proces. "Ky president nuk ka legjitimitet e as kredibilitet", ka thënë Kurti. Po ashtu, Kurti ka thënë se Qeveria po e bojkoton Kuvendin për shkak se, sipas tij, ekzekutivi është duke e luftuar opozitën dhe atë para syve të kryeparlamentarit Kadri Veseli.



Veseli priti në takim lamtumirës ambasadorin amerikan, Delawie

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, i cili së shpejti përfundon misionin në vendin tonë. Kryeparlamentari Veseli ka falënderuar ambasadorin amerikan për kontributin e pazëvendësueshëm për shtyrjen përpara të shumë proceseve pozitive në

vendin tonë si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer ndër vite.

Veseli ka thënë se bashkëpunimi dhe miqësia midis Kosovës dhe ShBA-së tashmë është e çimentuar dhe e pakthyeshme. Duke i uruar diplomatit amerikan sukses të reja në karrierën e tij të mëtejshme, Veseli ka shfaqur përkushtimin për ta vazhduar bashkëpunimin me drejtuesin e ri të Ambasadës Amerikane në

Prishtinë.

Ambasadori Delawie u shpreh i lumtur që për disa vjet ka drejtuar misionin diplomatik amerikan në Kosovë, ndërsa ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli për bashkëpunimin.

Delawie ka konfirmuar edhe një herë se ShBA-ja do të vazhdojë të mbetet mbështetëse e Kosovës në ecjen e saj përpara dhe për kapërcimin e sfidave që ajo ka para vetes.



Kërkohet edhe më tutje përkrahja për vizat nga Parlamenti Evropian

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ka përfunduar të martën në Prishtinë punimet sesioni i dytë i punimeve të mbledhjes së pestë të përbashkët të Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë. Takimi i së martës është kryesuar nga Tonino Picula, kryetar i delegacionit të Parlamentit Evropian, ndërkaq temat për të cilat u diskutuan me këtë rast ishin: sundimi i ligjit (lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar), liberalizimi i vizave, bashkëpunimi rajonal, dhuna në familje dhe barazia gjinore si dhe ndihma para parlamentare e PE-së për Kuvendin e Kosovës.

Gjatë shtjellimit të këtyre temave deputetët Time Kadrijaj, Albulena Haxhiu, Arben Gashi, Blerta Deliu-Kodra, Memli Krasniqi (kryetar i Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë i Kuvendit të Kosovës), Elmi Reçica, Vjosa Osmani dhe Danush Ademi vunë në dukje angazhimet institucionale të Republikës së Kosovës për përbashkëpunimin e standardeve që kërkohen nga BE-ja lidhur me fushat përkatëse që u diskutuan me këtë rast.

Lidhur me disa çështje të caktuara, siç janë lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhuna në familje dhe gjendja në sektorin e drejtësisë, deputetët, duke



shfaqur opinionet e tyre, vlerësuan se Qeveria duhet të jetë edhe më e angazhuar për përbashkëpunimin e objektivave të parashtruara.

U vlerësua, ndërkaq, bashkëpunimi rajonal dhe sjellja e shtetit të Kosovës për të kontribuar për një ambient më të përshtatshëm dhe stabil të rajonit. Ndërsa u kritikua sjellja e shtetit të Serbisë, e cila pareshtur paraqet pengesa në rrugën e integritit të Kosovës në mekanizmat rajonale dhe

më gjerë.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës vëmendje të theksuar i kushtuan liberalizimit të vizave dhe nevojës që ky proces të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër. Ata, pasi falënderuan kolegët e tyre nga PE-ja për ndihmën e gjertanishme, po ashtu i siguruan ata se liberalizimi i vizave nga qytetarët tanë do të shfrytëzohet sipas rregullave të paracaktuara dhe nuk do të keqpërdoret mundësia e lëvizjes së lirë. Për përfundimin

me sukses të këtij procesi deputetët e Kuvendit të Kosovës kërkuan nga kolegët e tyre të PE-së ta vijnë përkrahjen e plotë sikurse që është parë deri më tani.

Lidhur me temat e parapara për këtë sesion, folën edhe eurodeputetët: Lukas Mandel, Julie Ward dhe Dubravka Shuica, të cilët vunë në dukje rëndësinë e sundimit të ligjit, bashkëpunimin rajonal, sundimin e ligjit, si dhe çështje të tjera që do ta avanconin

pozitën e vendit tonë në arenën ndërkombëtare. Me këtë rast ata theksuan angazhimin e tyre për arritjen e liberalizimit të vizave dhe premtuan, po ashtu, angazhim të mëtejshëm deri në përfundimin final të këtij procesi. Pas shterimit të debatit, komisioni miratoi një deklaratë të përbashkët, nëpërmjet së cilës dalin detyrimet e ndërsjella deri në takimin e radhës, i cili u vendos të mbahet më 13 dhe 14 mars të vitit të ardhshëm në Strasburg.

Ministri Gashi javën e ardhshme raporton në Komisionin për Punë të Brendshme

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në mbledhjen e së martës, i kryesuar nga Haxhi Shala, kryetar, ka shqyrtuar planin e punës së Komisionit për sesionin vjetor të vitit 2018. Nga ana e anëtarëve të Komisionit u theksua

se aktivitetet që nuk janë realizuar në sesionin pranveror të barten për sesionin vjetor, në mënyrë që të kompletohet plani i punës. Gjithashtu u theksua të përcaktohen prioritetet në Komision, në mënyrë që aktivitetet e planifikuara të realizohen. Komisioni u pajtua që, pas plotësimeve në planin e

punës, të miratohet në Komision. Po ashtu, u vendos që javën e ardhshme të ftohet në raportim në Komision ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, në mënyrë që të realizohet edhe një dëgjim paraprak, para përfundimit të raportit për mbikëqyrjen e Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës.



Publikimi i listave të veteranëve, me të dhëna personale që dyshohen të jenë të rreme, ka nxitur reagime të shumta

Publikimi i të dhënave personale të veteranëve, në kundërshtim me ligjin

Shoqëria civile, njohësit e sistemit të drejtësisë dhe OVLUÇK-ja kanë kritikuar për publikimin e listave me të dhëna personale të veteranëve që dyshohen të jenë të rreme. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) kanë vlerësuar se kjo paraqet shkelje flagrante të të drejtave të njeriut të garantuar me norma vendore dhe ndërkombëtare. Sipas tyre, në këtë shkelje përgjegjëse është edhe Prokuroria e Shtetit



Ndërsa kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ka kërkuar nga Prokuroria të kërkojë falje për këtë veprim. "Prokuroria jo vetëm se duhet në mënyrë sa më të shpejtë t'i bëjë këto përmirësime, por të kërkojë falje publike ndaj këtyre individëve, emrat e të cilëve u njollosën, kurse mundi dhe sakrifica e tyre u përlyhen në një listë, kinse ata kanë qenë veteranë të rrejshëm. Ndihej i zhgënjyer nga prokuroria se si ka arritur të bëjë gabime të tilla. Kjo është një fyerje për veteranët e vërtetë, sepse as familjarët dhe miqtë e tyre sot nuk ndihen mirë. Tashmë as fëmijët e veteranëve në shkolla nuk e ndiejnë veten mirë, ndonëse baballarët e tyre kanë qenë luftëtarë të UÇK-së prej fillimit deri në përfundim të luftës", ka thënë Gucati për gazetën "Epoka e re".

Madje ai ka paralajmëruar edhe padi ndaj atyre që i kanë publikuar këto lista. "Nuk do të protestojmë tani, por i bëjmë thirrje prokurorisë që këto lista t'i pastrojë sa më shpejt dhe të kërkojë falje publikisht për shokët tanë që ua ka vënë emrat në to. Presim të dimë se kush i ka publikuar këto lista, prokuroria apo portalet pa dijeninë e prokurorisë. Do të ngrehim padi ndaj tyre", është shprehur Gucati.

Ditë më parë disa medie kanë publikuar listat e veteranëve që dyshohen të jenë mashtrues. Në këto lista, së bashku me emrat e tyre, janë publikuar edhe numrat personalë të letërnjoftimit të këtyre personave së bashku me të dhënat e tjera, si: vendin e lindjes, vitin e lindjes.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Publikimi i të dhënave personale në listat e veteranëve që dyshohen të jenë të rreme nga prokuroria është vlerësuar shkelje e rëndë e ligjit dhe të drejtave të këtyre personave. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë vlerësuar se publikimi i të dhënave personale është i dënueshëm me të gjitha ligjet dhe dokumentet ndërkombëtare dhe vendore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. "Publikimi i listave të veteranëve, që dyshohen të jenë mashtrues, e të gjitha të dhënat personale, pa një vendim të gjykatës kompetente, përveçse paraqet shkelje të rëndë të Ligjit për ruajtjen e të dhënave personale, në të njëjtën kohë paraqet shkelje flagrante të të drejtave të njeriut i cili është i dënueshëm me të gjitha ligjet dhe dokumentet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndërkombëtare dhe kombëtare. Për më keq, në këto lista, tash të zgjeru-

ara, ka emra, kontributi i të cilëve nuk mund të kontestohet me asgjë në luftën e fundit në Kosovë", është thënë në komunikatën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj).

Sipas këtij këshilli, linçimi dhe degradimi publik i kontribuesve të pamohueshëm në luftën çlirimtare është bërë nga ata që me ligj dhe në zbatim të ligjit janë të detyruar t'i mbrojnë këto të drejta. "Thirrja e tyre, që të lajmërohen në prokurori a gjykatë, për t'i përmirësuar këto 'gabime' që shkaktojnë reagime të shumta, plotësisht të drejta dhe të arsyeshme nga kontribuesit e vërtetë apo veteranë të vërtetë të luftës çlirimtare dhe të cilët, me qëllim apo pa qëllim u barazuan me veteranët mashtrues. Këto lista të paverifikuara, të sajuara shkel e shko dhe pa vendim të gjykatës që do ta vërtetonin gjendjen faktike, ngehen tensione të shumta në Kosovë sikur që krijuan situata që e rrezikojnë jetën të prokurorisë dhe të gjyqësorit, ashtu edhe të atyre që janë në lista", ka vlerësuar KMDLNj-ja. Më tej, ky këshill ka kërkuar të vazhdojë procedura gjyqësore ndaj atyre që kanë përfutur

kundërligjshëm nga statusi i veteranëve mashtrues si dhe ndaj atyre që ua kanë mundësuar këtë veprim, pa ndërhyrje politike dhe pa ndërhyrje të grupeve të tjera të interesit. "KMDLNj-ja është kundër faljes për veteranët mashtrues dhe nëse gjykata kompetente e vërteton fajësinë e tyre, ata duhet të dënohen në përputhje me ligjin sikur që duhet të detyrohen t'i kthejnë mjetet që i kanë përvetësuar në sajë të mashtrimit. Në këtë rast, në asnjë mënyrë nuk do të duhej të kalojnë të pandëshkuar ata që i futën në lista veteranët e vërtetë të UÇK-së sikur edhe ata që ua dorëzuan listat medieve elektronike e që e shkaktojnë tërë këtë rrëmujë që ka tendencë destabilizimi të situatës", është thënë në këtë komunikatë.

Edhe njohësi i sistemit të drejtësisë nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka kritikuar publikimin e të dhënave personale në këto lista. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se futja në aktakuzë e emrave

të personave dhe të dhënat e tyre personale të cilët nuk janë të akuzuar paraqet shkelje. "Në radhë të parë Prokuroria, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe praktikën prokuroriale, për herë të parë në një aktakuzë fut emrat e personave dhe të dhënat e tyre personale, të cilët nuk janë të akuzuar. Sikurse e ka dhënë edhe vetë Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një qasje e tillë e prokurorisë bie ndesh me Ligjin dhe parimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të personave që janë publikuar të dhënat e tyre", ka thënë Miftaraj, duke shtuar se në Kosovë të drejtat shkelen nga ato institucione që janë të obliguar t'i mbrojnë ato. "Edhe më shqetësues është fakti lidhur me mungesën e sigurisë juridike të qytetarëve të Kosovës dhe se të drejtat e tyre shkelen në mënyrë masive nga po ata që në bazë të Kushtetutës dhe ligjit do të duhej të ofronin mbrojtje dhe siguri", është shprehur Miftaraj.

Gjykata e Apelit vërteton dënimin për Kurtin, Haxhiun, Kadaj-Bujupin dhe Topallin

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Gjykata e Apelit ka vërtetuar dënimin me burgim me kusht për liderin e Lëvizjes Vetëvendosjes (LV), Albin Kurti, deputeten Albulena Haxhiu, deputeten Donika Kadaj-Bujupi dhe për deputetin Faton Topalli. Vendimi i Apelit është marrë pas ankesave, ndërsa lajmi është konfirmuar nga zëdhënësi i gjykatës, Arbër Jashari. "Vendimi i Gjykatës së Apelit është që vendimi i shkallës së parë të vërtetohet", ka thënë Jashari, raporton "Kallxo.com". Për përdorim të armës, deputeti Albin Kurti është dënuar me një vit e tre muaj burgim, për pengim të personit zyrtar me gjashtë muaj

burgim. Dënimi unik: 1 vit e 6 muaj burgim. Dënimi është me kusht me periudhë verifikimi dyvjeçar. Deputetja Albulena Haxhiu për përdorim të armës është dënuar me një vit e dy muaj burgim. Për pengim të personit zyrtar me katër muaj burgim. Dënimi unik: 1 vit e tre muaj burgim. Donika Kadaj-Bujupi për përdorim të armës është dënuar me një vit e tre muaj burgim, për pengim të personit zyrtar me gjashtë muaj burgim. Dënim unik: 1 vit e gjashtë muaj burgim. Ndërsa deputeti Faton Topalli për përdorim të armës është dënuar me një vit burgim dhe për pengim

të personit zyrtar me tre muaj burgim. Dënimi unik: 1 vit e dy muaj burgim. Të gjitha këto dënime janë me kusht me periudhë verifikimi dyvjeçar. Të katër deputetët e Kuvendit të Kosovës akuzohen për hedhje të gazit në seancën e Kuvendit të Kosovës me qëllim të pengimit të ratifikimit të Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi dhe Marrëveshjen për Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe. Gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor deputetët deklaruan se veprimet e tyre ishin vetëm në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës.



Komuna e Shtimes bëhet me E-kioskë

SHTIME, 18 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Muhadin Halili, kanë përruruar E-kioskun e parë në këtë komunë, në të cilin qytetarët mund të pajisen me dokumentet e gjendjes civile. "Sot po promovojmë E-kioskun dhe theksoj se kësaj ofrohen shërbime më të lehta për qytetarët, pasi ata nuk duhet të presin më në sportelet e administratës lokale për të njëjtat dokumente. Në kuadër të këtij projekti, ofrojmë shërbimin që qytetarët të pajisen më shpejt me dokumentet e gjendjes civile", ka thënë Ismajli.

Ndërsa drejtori i Administratës së Përgjithshme të Shtimes, Muhadin Halili, ka theksuar se E-kioskun do të jetë në shërbim 24 orë. "Në kuadër të E-kioskut shërbimi i dhënies së dokumenteve të gjendjes civile do të jetë aktiv 24 orë në ditë dhe shtatë ditë në javë, derisa qytetarët do të mund t'i marrin këto dokumente: ekstraktin e lindjes, certifikatën e lindjes, certifikatën e martesës, certifikatën e shtetësisë dhe certifikatën e vendbanimit. Parashihet që shumë shpejt qytetarët do të kenë mundësi t'i nxjerrin edhe dokumentet e tjera si ajo e tatimit në pronë dhe gjeodezi", ka bërë me dije Halili.



Prishtina bëhet me kioskë turistike

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka hapur kioskën turistike në të cilin vizitorët mund të marrin çfarëdo informate për vizitorët. "Nga sot të gjithë turistët dhe viz-

itorët që vijnë në Prishtinë dhe që kanë nevojë për informata, mund të drejtohen në kioskun turistik në Sheshin 'Zahir Pajaziti'. Kioska turistike është pjesë e pilotprojektit me PPSE Program

Swisscontact dhe ka mbledhur e prodhuar materiale të ndryshme turistike, një pjesë prej të cilave janë përpiluar enkas për këtë informacion qendër", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Komuna e Prizrenit arrin marrëveshje me 'Infrakos'-in

PRIZREN, 18 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka bërë me dije se ka arritur marrëveshje me "Infrakos"-in për lirim të trasesë së hekurudhës në Prizren. "Siç ju kemi njoftuar edhe më parë, Komuna e Prizrenit për më shumë se gjashtë muaj nuk ka mundur të lëshojë leje ndërtimore si

pasojë e vendimit gjyqësor që kishte të bënte me uzurpimin e pronave të hekurudhës, gjegjësisht ndërtimit në brezin e saj pa bazë ligjore. Për ta zhbllokuar këtë vendim gjyqësor komuna arriti të bëjë marrëveshje me ndërmarrjen 'Infrakos', e cila i menaxhon hekurudhat, duke u obliguar që së bashku me ekipin e tyre

në terren ta bëjnë lirim të trasesë së hekurudhës. Pronarët e objekteve në brezin e hekurudhës paraprakisht janë njoftuar me vendimin për t'i liruar vetë ato hapësira. Ndërhyrjet e inspektoratit në këtë zonë po bëhen vetëm për rastet ku ka ndërtime në pronën e hekurudhës", ka theksuar Haskuka.

Muharremaj kërkon përfundimin me kohë të projekteve

THERANDË, 18 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, është takuar me mbikëqyrësit e projekteve që janë duke u realizuar në këtë komunë. Gjatë këtij takimi ai ka kërkuar nga mbikëqyrësit përfundimin me kohë të të gjitha projekteve. "Projektet që janë duke u realizuar në territorin e Komunës së Suharekës duhet të përfundojnë

me kohë të paraparë. Sot i kam ftuar në takim mbikëqyrësit e projekteve për të parë se deri ku kanë mbërritur punët që po bëhen në terren. Kam kërkuar nga ata të jenë vazhdimisht në terren që punët të përfundojnë sipas afateve të parapara me kontratë, gjithmonë duke e pasur parasysh cilësinë e punimeve", ka thënë Muharremaj.



Gjini: Do të angazhohem që asnjë shkollë të mos ngrohet me stufa

GJAKOVË, 18 SHTATOR (ER) - Në kuadër të vizitave nëpër shkollat, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, së bashku me bashkëpunëtorët, ka vizituar të martën Shkollën Filllore "Emin Duraku". Gjini u ka thënë mesimdhënësve të

kësaj shkolle të ndihen të nderuar me punën e tyre. "Është nder të punosh për ndërtimin e brezave, andaj në këtë fillimvit shkollor dua t'ju uroj suksese në punën tuaj mesimdhënës", ka thënë Gjini.

Më tutje, Gjini ka premtuar se gjatë këtij mandati do të kujdeset që asnjë shkollë në Komunën e Gjakovës të vazhdojë të ngrohet me stufa. "Kur përfundojmë detyrat bazike mund të vazhdojmë me hapa të tjerë", është shprehur Gjini.



Ministri Reçica ofron përkrahje për komitetin e grave të verbra

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, është takuar të martën me drejtreshën e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës (KGVK), Bajramshahe Jetullahu dhe përfaqësues të këtij komiteti, me të

cilët ka biseduar rreth pozitës së të verbërve në Kosovë dhe bashkërendimit të veprimeve me qëllim të përkrahjes më të madhe të kësaj kategorie, veçanërisht femrave.

Ministri Reçica ka thënë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies

Sociale është e përkushtuar për t'ua dhënë përkrahjen e merituar kategorive më të cenueshme në bazë të kapaciteteve që ka, me qëllim të sigurimit të një mirëqenie të duhur për to. "MPMS-ja është duke punuar për krijimin e një ligji gjithëpërfshirës për per-

sona me aftësi të kufizuara me anë të të cilit do të avancohet trajtimi ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe do të shmangen problemet që e kanë shoqëruar këtë kategori deri më tani", ka thënë Reçica. Ndërsa drejtoresha Jetullahu e ka falënderuar min-



Ministri Reçica për pritjen dhe gatishmërinë për ta përkrahur këtë kategori.

Të hyrat financiare për muajin gusht në Telekom arritën mbi tetë milionë euro

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, gjata takimit që ka pasur të martën me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se si rezultat i përpjekjeve të menaxhmentit të ri për ta ndryshuar trendin biznesor të kësaj ndërmarrje, në muajin gusht të këtij viti të hyrat financiare kanë arritur në nivelin 8.7 milionë euro ndërsa, sipas tij, edhe muaji korrik ka qenë në këtë shkallë pozitive



arritur në nivelin 8 milionë e 741 mijë euro, ndërsa edhe muaji korrik ka qenë në këtë shkallë pozitive, që tregon se qytetarët, konsumatorët dhe bashkatdhetarët tanë gjithnjë e më shumë janë duke përdorur shërbimet dhe produktet e Valës", ka thënë Begolli.

Megjithatë, ai ka thënë se Telekom i Kosovës vazhdon ende të përballet me vështirësi. "Telekomi i Kosovës në të vërtetë është në një krizë të madhe për arsye se nga menaxhmenti i kaluar kemi trashëguar shumë borxhe të ndryshme. Shumë kontrata që nuk janë të mira. Gjithashtu, kemi trashëguar numër të madh të punëtorëve, me gradime mbi gradime dhe nuk dihet saktë përshkrimi i vendeve të punës", ka thënë Begolli. Ai ka treguar se me ministrin Lluka kanë diskutuar edhe rreth investimeve të nevojshme në infrastrukturën e vjetruar të Telekomit të Kosovës, e cila do të rezultojë me përkrahjen e produkteve të reja. Kjo, sipas Begollit, do ta shtojë numrin e klientëve të rinj dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e të hyrave të përgjithshme.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka vizituar të martën Telekomin e Kosovës, ku është pritur nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrje, Gent Begolli. Në këtë vizitë ministri Dugolli është njoftuar për gjendjen aktuale në Telekomin e Kosovës si dhe për masat e ndërmarra nga menaxhmenti i ri, në koordinim me Bordin e Drejtorëve, për rimëkëmbjen e Telekomit të Kosovës.

Ministri Lluka në një konferencë për medie, pas takimit me Begollin, ka thënë se vizita e tij kishte për qëllim për të kuptuar nga afër situatën në të cilën ndodhet kjo ndërmarrje. Ai ka

siguruar mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për të bërë zgjidhje për krizën në të cilën ndodhet Telekom. "Do të bashkëpunojmë që të kthehet imazhi pozitiv i Telekomit. Më bën të lumtur lajmi që në dy muajt e fundit të hyrat janë rritur. Gjithashtu, e kuptova se qiraja është zvogëluar për 20 deri në 30 për qind. Qëllimi ynë është ta inkurajojmë Bankën Botërore dhe BERZh-in të inkuadrohet për ristrukturimin e Telekomit. Po ashtu, punësimi është reduktuar, gjithashtu edhe shpenzimet", ka thënë ministri Lluka.

Kurse sa iu përket pagave të punëtorëve të Telekomit, ministri Lluka ka thënë se duhet të bëhet një vlerësim korrekt i mënyrës së gradimit të punë-

torëve. Ai ka pohuar se pagat duhet të ulen në mënyrë që kjo kompani të shpëtojë nga kriza në të cilën gjendet. "Ajo çfarë kemi thënë nga fillimi është se për ta shpëtuar Telekomin dhe për ta nxjerrë në një ndërmarrje fitimprurëse duhet të ulen pjesërisht pagat", ka thënë Lluka. Ai ka shtuar se që nga ardhja në krye të kompanisë të menaxhmentit dhe bordit të ri janë zotuar të bashkëpunojnë

ngushtë për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve zhvillimore të Telekomit të Kosovës. Ndërkaq kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, ka bërë me dije se kjo ndërmarrje ka pasur rritje të të hyrave për muajin gusht në nivelin 8.7 milionë euro. "Si rezultat i përpjekjeve tona për ta ndryshuar trendin biznesor të kompanisë, në muajin gusht të këtij viti të hyrat financiare kanë

Industria e përpunimit shënon rritje

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Në tremujorin e dytë të vitit 2018, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti, ka pasur rritje industria nxjerrëse me 65.96 për qind dhe industria përpunuese me 36.90 për qind, kurse rënie kanë shënuar sektori i furnizimit me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave për 21.55 për qind dhe ai i furnizimit me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me -21.42 për qind. Sipas indeksit të vëllimit industrial, për tremujorin e dytë 2018 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, krahasuar TM2 2018 me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, ka pasur rritje te sektori i



industrisë nxjerrëse me 9.93 për qind, furnizimi me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave me 5 për qind dhe tek industria përpunuese me 0.11 për qind. Rënie ka pasur te furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për -9.3 për qind.

Rrjeti i ri energjetik në Shkrel të Rugovës ndihmon zhvillimin e turizmit

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Një nga fshatrat më të mëdhenj në rajonin e Rugovës ka përfitur rrjet të ri elektrik nga një projekt i zhvilluar nga KEDS në bashkëpunim me Komunën e Pejës. Ky projekt, përveçse përmirëson dukshëm kualitetin e furnizimit me energji elektrike për rreth 50 shtëpi të këtij fshati, është i rëndësishëm edhe për zhvillimin e turizmit në këtë pjesë të vendit.

Projekti përfshinë investime të ndryshme, siç janë vendosja e një trafo shtyllë metalike, transformatori dhe vendosja e kabllor nëntokësore me gjatësi prej afër 3.5 kilometrave. Po ashtu, janë vendosur mbi 50



shtylla të betonit për tension të ulët dhe një tjetër për tension të mesëm. Viktor Buzhala, zëdhënës i KEDS-it, ka thënë se ky projekt është në kuadër të investimeve që kjo kompani është duke bërë në të gjithë Kosovën.

Ministri Beqaj merr pjesë në Festivalin e Inovacionit në Tiranë

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj, do të marrë pjesë në Festivalin e Inovacionit që mbahet në Tiranë nga 18 deri më 20 shtator.

Ministri Beqaj në ditën e dytë të Festivalit do t'u drejtohet pjesëmarrësve me qëllim të prezantimit të kapaciteteve dhe mundësive të Kosovës në fushën e teknologjisë, inovacionit dhe ekonomisë digjitale, me ftesën

për bashkëpunim në mes të kompanive të rajonit me kompanitë e Kosovës në këtë fushë. Festivali ka karakter rajonal ku pritet të jenë të pranishëm mbi 500 pjesëmarrës dhe do ta prezantojnë punën e tyre 50

kompani të rajonit. Gjatë qëndrimit në Tiranë, ministri Beqaj do të takojë zëvendëskryeminstren e Shqipërisë, Senida Mesi, dhe udhëheqës të tjerë të lartë institucionalë të Shqipërisë.



JETA NË RRUGËTIM E HAKI MORINËS


Lulëzim ETEMAJ

Sapo pashë një film amerikan të bazuar në një ngjarje të vërtetë nga Lufta e Dytë Botërore, ku në kampin japonez të robërve torturoheshin ushtarët amerikanë në mënyrë të tmerrshme.

(Haki Morina, "Jetë në rrugëtim", Shtëpia Botuese "Lena", Prishtinë 2018, faqe 114)

Unë sapo e mbarova së rilexuari këtë libër të Haki Morinës dhe, si të isha në një kino gjigante filmi, pashë Hakiun dhe shumë bashkëvuajtës të tij, se si torturoheshin filimisht nga udbashët dhe gardianët shqiptarë e më pastaj edhe të kombeve tjera, para së gjithash atij serb, vetëm pse kërkonin liri, statusin e Republikës për Kosovën, të drejta njerëzore dhe kombëtare.

Po ashtu, pash vullnetin e tyre të çeliktë për të dhënë gjithçka nga vetja e tyre, pa u thyer asnjëherë, në funksion të suksesit të përpjekjes së tyre. Nuk mund të presësh faktikisht asgjë më pak nga gjenerata e tij, kur që në moshë 17-18 vjeçare e ka përzgjedhur heroin, në këtë rast



hiq më pak se Adem Demaçin, dhe shpreh hapur dëshirën dhe përcaktimin për t'u bërë si Adem Demaçi, siç shprehet Haki Morina në këtë libër, faqe 27.

Ushtarët amerikanë, robër, mbase shumë prej tyre edhe nuk jetojnë më, porse SHBA tashmë është kryefjala e rendit demokratik botëror.


Haki Morina i ka mbijetuar torturat dhe ferrin, por ka

bashkëvuajtës dhe bashkëveprimtarë të tij që nuk ia kanë arritur t'i dalin mbanë të gjallë sfidës. E ka mbijetuar sfidën dhe falë luftës së UÇK-së, themelues dhe drejtues të së cilës ishin bashkëveprimtarë dhe bashkëvuajtës të Haki Morinës, Kosova ka fituar lirinë dhe statusin e Republikës. Gjithsesi që kjo paraqet një shpagim të madh, si për përpjekjet dhe vuajtjet e tij, të rrëfyera me mjeshtri në këtë libër, që meritueshëm hyn në grupin e librave që lexohen me një frymë, ashtu dhe për flijimet dhe luftën mbinjerëzore të luftëtarëve të UÇK-së. Përmes librit "Jetë në rrugëtim", autori Haki Morina, me anën e rrëfimit të tij të rrjedhshëm,

të strukturuar e të begatuar me spontanitet, ia ka dalë me sukses t'u sjellë lexuesve të të gjitha gjeneratave, posaçërisht të gjeneratës së re, një akt të rëndësishëm të dramës së Kosovës, përkatësisht të rrugëtimit të lirisë së saj. Gjithsesi libri i tij, "Jetë në rrugëtim" e pasuron dhe bën më të begat letërsinë memoaristike shqiptare të Kosovës.

Një 'engjëll flutur' vjen në gjuhën angleze

PRISHTINË, 18 SHTATOR- Ish-gazetari Lavdrim Avdyli, i cili është profesor i gjuhës angleze, ditë më parë ka botuar librin "Butterfly Angel", në të cilin ka përfshirë dhjetëra kode të jetës, të vdekjes, të suksesit, të dështimit etj. Avdyli është aforisti i parë shqiptar që këto aforizma i shkruan në gjuhën angleze. Me këto aforizma dhe këshilla të përmbledhura në këtë libër, autori nuk atyre që e kanë zemrën e egër dhe të fortë, ua zbut pak; ndërkaq atyre që e kanë zemrën e butë dhe të ndjeshme, ua forcon pak. Ai jep këshilla për të mirën, për të keqen, për të bukurën, për të shëmtuarën, për veset, për gabimet, për nderin dhe ndershmërinë, për respektin dhe intelektin, për kusarinë dhe koprracinë, për mosmirënjohjen, për dështimet, për pasurinë dhe për varfërinë, për sfidat dhe për të arriturat e vogla dhe të mëdha në jetë, për fjalën e keqe dhe të mirë, për dashamirësinë, për mikun dhe për armikun, për të ligën, për shpirtin dhe përjetësinë, për të tashmen, të kaluarën dhe të ardhmen e vet. Librin e tij mund ta gjeni në librarinë "Artini" dhe te shitësit e librave në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë.



XHEVDET BAJRAJ

EDHE NJË HERË PËR ATDHEUN

*Paramendoni jetën në atdhe
ku duart e politikanëve të korruptuar janë të gjata
sa hijet e mëngjesit
Nëse nuk ndryshojnë gjërat
kjo do të thotë
se ne si popull nuk kemi nevojë për demokraci
por për një psikiatër të mirë
Mua më dhimbsen nënat tona
janë si zogjtë e plakur në kafazin e kraharorëve tanë
që për shkak të moshës
nuk kanë mundur të emigrojnë me tufën e vet
dhe tani janë të detyruara të hanë
nga duart e këtyre njerëzve
qofshin ata edhe kriminelë*

NJË GRUA QË KISHTE DASHURUAR SHUMË

*Një grua e shndërruar në një grusht dheu
ende e mban mend
që dikur kishte dashuruar shumë
aq shumë
sa tani nga ajo
në një fushë pa Zot
mbinë lule
Nganjëherë
por vetëm nganjëherë
kafshët u afrohen
i nuhasin ato
e dridhen
pastaj e lëshojnë një zë
të dhimbshëm
si në ditën e parë të botës*

MAJA E VETMISË

*Diku në dhë të huaj
fusha e kujtimeve çel lule me fytyra njerëzish
nën peshën e dashurisë
dhimbjes vetmisë
nën peshë malli njerëzor
në emër të lirisë
bredh nëpër botë
si porosi në shishe mbi fshehtësi oqeani
kërkon yllin në qiell drurin në tokë
kërkon dorë njeriu ta shpalosësh mallin
ta shpalosësh dhimbjen palë-palë
ti
i madhi
i urti baba
rri majë vetmie
si majë thike
pret diellin e Kaçanikut
si lule mëngjesi vesën ta shkundë*

E jashtëzakonshme

Japonia ka gati 70 000 njëqindvjeçarë

Në raport me vitin e kaluar numri i 100-vjeçarëve në Japoni është rritur për tre qind dhe tash në nivel rekord janë 69 785 personash në këtë moshë, prej tyre 90 për qind janë femra, ka njoftuar qeve-

ria japoneze. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Punës, rritja e plakjes sociale ka nisur të evidentohej 48 vjet më radhë.



Në vitin 1963 në Japoni kanë jetuar vetëm 153 njëqindvjeçarë.

FOTO E DITES



Një aeroplan përgatitet ta bëjë uljen e tij në San Diego, duke zbritur mbi trafikun me orë të nxehta. /Foto: nationalgeographic/

E rrallë

Hyri të merrte ushqime në dyqan, gjeti macen që e kishte zënë gjumi poshtë raftit

Melanie Morris-Jones kishte hyrë të blinte pije në një dyqan në Rugby të Anglisë, ku mbeti e habitur me një mace që e pa teksa flinte poshtë rafteve. Gjallësa që kishte gjetur këndin e ushqimeve për kafshë, pasi ka



ngrënë prej një kutie, është shtrirë dhe ka fjetur. "Sigurisht ishte e lodhur dhe pasi u ngop, e zuri gjumi. Më bëri të shikoja dy herë, sepse nuk po u besoja syve", ka thënë Morris-Jones.

BARSOLETA E DITËS



Një bionde, teksa ecën rrugës, ndal një kalimtar:
- Më falni, çfarë do të thotë "I don't know"?
- "Nuk e di", i përgjigjet kalimtari.
- O Zot, askush nuk e ditka!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

"THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Mbi disa argumente që nuk keni dijeni nuk keni pse debatoni. Do të tregonit që jeni të pa informuar mirë lidhur me tema të caktuara.



DEMI
Një ditë e tërë ne shoqërinë e vetes tuaj sot mund ju bëjë veçse mirë. Ju shijon të ecurit në rrugë shpenguar ose leximi i një libri të mirë.



BINJAKËT
Edhe pse nuk keni gjithçka nën kontroll, kjo nuk do të thotë që nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



GAFORRJA
Nuk mund të lejoni që personat tuaj të afërt të jenë neglizhente me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes tuaj gjërat do të rregullohen.



LUANI
Keni shumë gjëra që kanë lidhje me administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën me herët se zakonisht.



VIRGJERESHA
Nëse doni të vini nën presion personat afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë që kjo sjellje është e mirë.



PESHORJA
Njerëzit pranë jush e kanë harruar sa person i bukur jeni në shoqëri. Kjo sepse ju jeni shmangur prej kohësh kontaktit me të tjerët.



AKREPI
Kushtet komode që keni pasur i keni rifituar kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkonte kontakte të reja.



SHIGJETARI
Keni rifituar terrenin e humbur në një çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.




BRICJAPI
Jeni pak të ndrojtur në kontaktin e parë me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonistet e situatave.



UJORI
Nëse nuk doni që dikush t'ju vë me shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, duhet patjetër të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



PESHQIT
Ditëve të fundit keni hasur në pengesa që nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të renduar shpirtërore.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

MANCHESTER CITY - LYON

3+

AJAX - AEK ATHENS

1-1

REAL MADRID - ROMA

4+

Erza mund t'i sjellë Kosovës medalje olimpike

"Dëshira e madhe për sportin e xhudos më ka frymëzuar të merrem me këtë sport. Nuk kam pritur ta fitoj normën olimpikë por, pas sukseseve të njëpasnjëshme në këtë vit, ia arrita këtij qëllimi", ka thënë Erza Muminoviq

PRISHTINË, 18 GUSHT - Erza Muminoviq është garuesja e vetme me normë që do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Olimpikë Verore për të Rinj, "Buenos Aires 2018", të parat për Kosovën. Xhudistja nga Peja është kampione e Evropës për kadete (U-18). Ajo fitoi medaljen e artë në evropianin e mbajtur në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës në fund të muajit qershor të këtij viti. 16-vjeçarja, e "prodhuar" në "fabrikën" "Ippon", është kandidatë për të fituar medalje olimpikë në "Buenos Aires 2018". Ajo momentalisht kryeson renditjen botërore të xhudisteve në kategorinë -44 kilogramë. "Dëshira e madhe për sportin e xhudos më ka frymëzuar të merrem me këtë sport. Nuk kam pritur ta fitoj normën olimpikë por, pas sukseseve të njëpasnjëshme në këtë vit, ia arrita këtij qëllimi", ka

thënë Erza Muminoviq për "noc-kosovo.org". Trajneri i saj, Driton Kuka, e sheh Erzën kandidatë serioze për të fituar medalje në olimpiadën e të rinjve. Erza dhe Majlinda jo vetëm se janë të një klubi dhe kanë të njëjtin trajner, po i lidh edhe diçka tjetër. "Erza është një vajzë e lindur në Pejë dhe jeton vetëm 50 metra larg nga palestra e klubit 'Ippon', tregon Kuka për garuesen e vet, e cila është fqinje me Majlindën. "Është vajzë e talentuar, e cila potencialin në arenën ndërkombëtare e ka treguar sivjet. Për mua ajo është tregues që kemi krijuar kontinuitet të punës serioze dhe të rezultateve. Erza është kandidatë serioze për medalje në Argentinë. Ky është synimi ynë patjetër. Ka gjasa reale", thekson Driton Kuka. Por, a është Erza pasardhëse e Majlinda Kelmendit. "Për të folur



REZULTATET E ERZA MUMINOVIQIT GJATË VITIT 2018
Kampionati Evropian për Juniore (U-21) "Sofia 2018" - raundi i parë
Kampionati Evropian për Kadete (U18) "Sarajeva 2018" - medalja e artë
Kupa Evropiane U-21 "Leibnitz" - medalja e argjendtë
Kupa Evropiane për Kadete "Coimbra 2018" - medalja e argjendtë
Kupa Pan Amerikane U18 "Panama 2018" - medalja e artë
Kupa Evropiane për Kadete "Teplice 2018" - medalja e bronzte
Kupa Evropiane për Kadete "Berlin 2018" - medalja e artë
Kupa Evropiane U21 "Sarajeva 2018" - medalja e argjendtë
Kupa Evropiane "Zagreb 2018" - medalja e bronzte
Kupa Evropiane "Antalya 2018" - vendi i 5-të
Kupa Evropiane "Follonica 2018" - medalja e argjendtë

se a kemi një pasardhëse të Majlindës është herët të flitet, por Erza me punë serioze besoj se do të bëhet sportiste kulminante në të ardhmen", shton përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës. "Mendoj se jo vetëm për mua, por për të gjithë xhudistët idhulli ynë është Majlinda Kelmendi", shprehet Erza. Optimist se Erzën do ta shohim në podium është edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. "Nisur nga fakti se Erza është renditur e para në renditjen botërore për kadete (kategoria -44 kg), dhe mbështetur në përgatitjet e realizuara nga KOK dhe Federata e Xhudos së Kosovës, jam i bindur se Erza do të ngjitet në podium për medalje", tha presidenti Hasani. Kosovën në "Buenos Aires 2018" do ta përfaqësojnë edhe katër sportistë të tjerë: Erdonis Maliqi (boks), Muhamet Ramadani (atletikë), Bleron Fetaovski (peshëngritje) dhe Melisa Zhdrella (not), të cilët përfaqësohen me ftesë. LOV për të rinj "Buenos Aires 2018" mbahen prej 6-18 tetorit në Buenos Aires të Argentinës.

Gashi, notarëve: Do të ndërtojmë pishina

"Do ta bëjë maksimumin që notarët e Kosovës t'i kenë hapësirat e nevojshme për t'i realizuar aktivitetet dhe garat e tyre. Me investimet që do të bëjë MKRS-ja në vitin e ardhshëm do të ndikohet edhe në edukimin e qytetarëve për notin dhe të reduktohen rastet kur, si pasojë e mospërvetësimit dhe edukimit të duhur për notin, humbasin edhe jetën e tyre", ka thënë ministri Gashi

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur sot në takim drejtuesit e Federatës së Notit të Kosovës, të udhëhequr nga kryetari i kësaj federate, Imer Rama. Në takim është biseduar për infrastrukturën fizike për sportin e notit dhe për plotësimin e saj nëpër qendrat e ndryshme të Kosovës. Konkretisht u diskutua për fillimin e investimeve që pritet të realizohen në vitin e ardhshëm.

Në këtë drejtim ministri Gashi u zotua se do ta fusë në plan ndërtimin e disa pishinave gjysmolimpikë për vitin 2019. Kryetari Rama e informoi ministrin Gashi edhe për aktivitetet që organizon Federata e Notit si dhe për sukseset që kanë arritur notarët. Ai mirëpriti zotimin e ministrit për investimet që ka në plan MKRS-ja të realizojë. Rama konsideroi se përmes këtyre projekteve interesimi për sportin e notit do të rritet. "Do ta bëjë mak-



simumin që notarët e Kosovës t'i kenë hapësirat e nevojshme për t'i realizuar aktivitetet dhe garat e tyre. Me investimet që do të

bëjë MKRS-ja në vitin e ardhshëm do të ndikohet edhe në edukimin e qytetarëve për notin dhe të reduktohen rastet

kur, si pasojë e mospërvetësimit dhe edukimit të duhur për notin, humbasin edhe jetën e tyre", ka thënë ministri Gashi.

Sot zhvillohet ndeshja Prishtina - Gjilani

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Sot (e mërkurë) nga ora 18:00 zhvillohet ndeshja e mbetur e javës së parë në Ipko Superligën e

Kosovës në Futboll. Prishtina e pret skuadrën e Gjilanit nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet. Aktualisht "bard-

hekaltrit" renditen në pozitën e katërt me tetë pikë dhe me një fitore eventuale mund të kalojnë në pozitën e dytë me pikë të

barabarta me Feronikelin, kurse Gjilani është një pozitë më poshtë se Prishtina me një pikë më pak të grumbulluar.



Rossi: Nuk ia shtrëngoj dorën Marquezit

ROMË, 18 SHTATOR - Marrëdhënia në mes të Valentino Rossit dhe Marc Marquez prej disa vjetësh nuk është më e njëjta, dy pilotët që janë jo vetëm rivalë në pistë, por edhe "armiç", pasi prej kohësh nuk flasin. Përplasjet që dy pilotët kanë pasur shpesh në pistë e jashtë saj kanë bërë që

ata të mos e shohin më me dashuri njëri-tjetrin. Pas deklaratës së Marquezit, që është gati ta rikthejë marrëdhënien e dikurshme me pilotin italian, ka reaguar Rossi. "E dëgjova deklaratën e tij, më duket pak e çuditshme. Unë nuk kam probleme me Marc dhe nuk ka arsye për

të mos bërë paqe", u shpreh piloti italian i Yamaha. Por, Rossi ka refuzuar që një ditë t'i shtrëngojë duart me rivalin spanjoll, duke u shprehur: "Mjafton kaq, kjo marrëdhënie që kemi. Nuk ka nevojë të bëjmë formalitete të kota dhe t'i shtrëngojmë duart".



Ejupi: Josa ka kontratë trevjeçare me Prishtinën

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryetari i FC Prishtina, Remzi Ejupi, ka reaguar pas raportimit të medieve se Mirel Josa është afër largimit nga skuadra kryeqytetase, dhe se vendin e tij pritet ta zë trajneri Gentian Mezani. "Nuk e njoh dhe as që jam takuar me personin në fjalë që paskan aluduar portalet, Gentian Mezanin. Në fakt, tash pse unë njoh shumë njerëz të sportit dhe jam i rrethuar me ta nuk ka asnjë domethënie. Takohem me shumë kë me të cilët kam miqësi, por edhe me të tjerë që mund të jenë afër tyre dhe kjo nuk do të thotë asgjë. Ne kemi kryetrajner, ai është Mirel Josa me të cilin kemi kontratë trevjeçare. Prishtina nuk është klub lagjesh që t'i ndërroj trajnerët çdo tre-katër javë apo për qefin e dikujt. Me Josen kemi projekt. Josa nuk ka ardhur të dëshmohej në Prishtinë. Ai është dëshmuar shumë më herët para nesh. Ai ka dëshmuar me sukseset në Shqipëri, e sidomos me paraqitjet në Evropë. Ai ka ardhur që kreu atë bagazh të përvojës së tij ta sjellë te ne", ka thënë Ejupi për faqen zyrtare të



klubit "bardhekaltër". "Po ashtu i mirëkuptojmë brengat, njëkohësisht dëshirat e adhurueseve tanë, e veçmas 'Plisave' për fitore, me të cilët jemi në një rrugë dhe e duam suksesin së bashku, por ju lusim të na mirëkuptoni dhe të na besoni, të keni pak durim, sepse gjithçka do të vijë në vendin e vetë, sepse jemi në rrugën e duhur dhe të drejtë. Josa ka kontratë trevjeçare me ne, sikurse ne që i besojmë, duam që edhe ju ta mbështesni atë dhe klubin maksimalisht. Vetëm të bashkuar do t'ia dalim", ka deklaruar Ejupi, i

cili shkrimet për largimin e Mirel Josës i sheh si tendencë për të ndikuar në ndeshjen e nesërme që Prishtina e zhvillon ndaj Gjilanit. "Këto shkrime i shoh si sulme për të na dekoncentruar para ndeshjes me Gjilanin. Por, nuk do t'ia arrijnë asnjë prej këtyre portaleve nga Kosova apo Shqipëria. Nuk do të bëjmë gabime të tilla siç, ndoshta, kemi vepruar në vitet e fundit. Ftojme që mos t'u besoni thashethemeve dashakëqija e të qëllimshme, sidomos të disa të ashtuquajturave portale nga Kosova", ka përfunduar Ejupi.

Roma sfidon kampionët e Realit

MADRID, 18 SHTATOR - Kampionët e Real Madridit e nisin mbrojtjen e titullit në Ligën e Kampionëve sonte (e mërkurë) ndaj Romës. Kjo llogaritë ndeshja kryesore e kësaj nate në garën më të fortë në futboll dhe zhvillohet nga ora 21:00 në "Santiago Bernabeu". Ndeshje tjetër e fortë do të zhvillohet në Spanjë në mes të Valencias dhe Juventusit, kurse



Bayern Munchen i shkon skuadrës së Benficës. Kampioni

i Anglisë, Manchester City, e pret Lyonin.

SONTE TAKOHEN:

18:55 Shakhtar D.-Hoffenheim
18:55 Ajax-AEK Athens
21:00 Benfica-Bayern M.
21:00 Manchester C.-Lyon
21:00 Real Madrid-Roma
21:00 Viktoria Plzen-CSKA M.
21:00 Valencia-Juventus
21:00 Young Boys-Manchester U.

Përfundon sezoni për Sharapovën

MOSKË, 18 SHTATOR - Maria Sharapova është detyruar t'i japë fund para kohe këtij sezoni, duke u tërhequr nga tre turnet e mbetur në vitin 2018 për shkak të një dëmtimi. Pesë herë kampionia në Grand Slam është prej kohësh në vështirësi, sepse në vitin 2016 u dënua 15 muaj për përdorim doping, pas një kontrolli gjatë Australian Open. Më pas, kthimi në fushë nuk ka qenë i thjeshtë, sepse ruses i ka munguar vazhdimësi dhe problemet fizike nuk i janë ndarë. Sharapova u kthye në fushë në vitin 2017, në

Stuttgart Open, por ka fituar vetëm një turne që atëherë - Tianjin Open tetorin e shkurt. Këtë vit Sharapova mbërriti deri në çerekfinalin e French Open, ku u mund keqas nga Garbine Muguruza. Ajo ka luajtur tre turne që atëherë - Uimbeldon, Rogers Cup dhe US Open, ndërsa tani WTA konfirmon se 31-vjeçarja do të kthehet në fushë në vitin 2019. "Po prisja me padurim të kthehesha në Kinë për ta mbrojtur titullin në Tianxin por, për fat të keq, më duhet kohë të riaftësohem nga një dëmtim. Jam



e zhgënjyer, sepse nuk do të kem mundësi të luaj përballë tifozëve në Kinë, por shpresoj se do të kem një tjetër shans më vonë", ka thënë Sharapova.

SHKURT

Më 20 shtator shorti për Superligën në futsall

Komisioni për futsall, në kuadër të përgatitjeve për edicionin e ri të garave, ka vendosur që më 20 shtator, në orën 17:00, të bëhet tërheqja e shortit për Superligën. Ndërkaq, më 22 shtator, në orën 11:00 do të mbahet seminari për delegatët e futsallit, derisa më 26 shtator, në orën 17:00, do të bëhet tërheqja e shortit për Ligën e Parë.

Presidenti i Barcelonës: Messi ka ndryshuar

Lionel Messi nuk është ai i dhjetë vjetëve më parë. Argjentinasi është tërhequr paksa në rolin e tij në fushë. Pas largimit të Iniestës, i cili ishte kapiteni i ekipit, 31-vjeçari është graduar me shirit në krahë. Presidenti i Barcelonës, Bartomeu, beson se Mesi e ka pritur shumë mirë këtë detyrë dhe ka ndryshuar shumë. "Ai është i lumtur këtu. Është i kënaqur dhe i entuziazmuar ende për të fituar. Ka bërë një ndryshim të madh, ka vendosur ta marrë shiritin e kapitenit dhe të ketë gjithë përgjegjësinë e ekipit", shprehet kreu i kampionëve të Spanjës.

Abrashi rikthehet nga lëndimi


Amir Abrashi pësoi një dëmtim të rëndë në gju, që e detyroi të kryente një ndërhyrje kirurgjikale. Hera e fundit që mesfushori kishte zbritur në fushë ka qenë më 10 mars të këtij viti ndaj Herthas. Abrashi la fushën e lojës i dëmtuar që në minutën e 29 dhe që atë herë ka qenë në fazë rikuperimi. Më në fund ka dritë në fund të tunelit për lojtarin e Kombëtares kuqezi, pasi vetë ai ka njoftuar përmes një postimi në "Instagram" se ka nisur të ushtrohet me top. Një periudhë relativisht e gjatë dhe e mundimshme për mesfushorin, i cili ka qenë një prej lojtarëve më të rëndësishëm të Kombëtares së Shqipërisë. Lajm i mirë për vetë lojtarin, por dhe për tifozët kuqezi, pasi për pak kohë Abrashi do të jetë gati për të zbritur në fushën e blertë.

Navasi, afër largimit nga Reali

Portieri Keylor Navas do të largohet nga skuadra e Real Madridit në janar të vitit të ardhshëm, raporton e përditshmja italiane "Marca". Navas, 31-vjeçar, nuk dëshiron të mbetet në "Santiago Bernabeu", pasi ka humbur vendin e titullarit në portë pas transferimit të belgut Thibaut Courtois. Navas tashmë ka njoftuar klubin për vendimin e tij dhe është në negociatë me disa skuadra nga Premierë Ligë. Ai është pjesë e Realit prej vitit 2014 kur u transferua nga Levante për dhjetë milionë euro. Me ekipin "mbretëror" ka kontratë deri në vitin 2020.


Ferdinand: Pogba duhet të mësojë nga Ronaldo

Mbrojtësi legjendar i Manchester Unitedit, Rio Ferdinand, ka thënë se mesfushori francez, Paul Pogba, duhet të mësojë nga ish-sulmuesi i klubit, Cristiano Ronaldo, për t'u përmirësuar sa më shumë si lojtar. "Kur erdhi, Cristiano kërkonte vetëm të dukej para tifozëve me të gjitha driblimet e tij. Por, ai u bë lojtar më i mirë në botë për shkak të golave dhe asistimeve. Por, kjo ka të bëjë me inteligjencën. Ronaldo e kuptoi se tifozët e pëlqenin atë për shkak të driblimeve, por ato nuk do t'i ndihmonin të bëhej lojtar më i mirë në botë, kështu që e ndryshoi stilin e tij. Dhe në fund, u largua si lojtar më i mirë në botë", ka thënë Ferdinand. "Kështu që Pogba mund të marrë mësim nga kjo gjë. Ai duhet të mendojë se çfarë u nevojitet për t'u bërë mesfushori më i mirë në planet? Ai ka një ego, këtë mund ta vërejmë lehtësisht nga rrjetet e tij sociale. Ai dëshiron të vlerësohet si lojtar më i mirë", ka deklaruar Ferdinand.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E ARSIMIT
UPRAVA ZA OBRAZOVANJE
DEPARTMENT OF EDUCATION

Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

	18/09. 2018
NR/BR.	1471
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për mësimdhënës
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Labjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs për mësimdhënës


Mbështetur në nenin 8, të Ligjit të Punës, neni 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT, it nr.10/2018 dhe 05/2015. Normativi për Kuadrin e Arsimit të përgjithshëm dhe arsimin profesional të MASHT, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS

Për mësimdhënës:

1. Në SHFMU "Rizah Matoshi" në Nikadin:
- Një mësues klase, (në zëvendësim).
2. Në SHML Gjinnazi "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj:
- Një mësimdhënës për fizikë për 12 orë, (në zëvendësim),
- Një mësimdhënës për biologji për 15 orë (në zëvendësim).
3. Në SHML Gjinnazi "Dr. Shaban Hashani" në Ferizaj:
- Një mësimdhënës për art figurative, për 9 orë dhe 6 orë në Gjinnazin "Kuvendi i Arbërit".

Kushtet: Për vendet e punës për mësimdhënës kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimeve Administrativ të MASHT- Normativi për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. **Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit. Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:
-Diplomën, ose Çertifikatën e diplomës së fakultetit, kopje e vërtetuar,
-Çertifikatën- ose ekstraktin e lindjes,
-Letërnjoftimi kopje,
Kohëzgjatja e Kontratës së punës fillon prej datës së fillimit të punës deri në kthimin e mësimdhënësve nga pushimi i lehonisë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.
Dokumentet nuk kthehen.
Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit, në tabelën e shpalljeve, në web faqen e Komunitet dhe në njërin nga mjetet e shkruara të informimit, duke filluar prej datës **18.09.2018, deri më 02.10.2018.**
DA – Ferizaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure


DEPARTAMENTI I AUTOMJETEVE / ODJEL ZA VOZILA / DEPARTMENT OF VEHICLE

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi qe ka Ministria Infrastrukturës mbështetur, në Udhëzim Administrativ 01/2018 për Kontrolla Teknike në nenin 3 pika 6 e këtij Udhëzim Administrativ shpall këtë:

Njoftim


Njoftohen të gjitha palët e interesuara për ofrimin e shërbimit me "Tiket ngjitëse" për automjete të cilat i nënshtrohen kontrollimit teknik.
Tiketa do të shërbej si dëshmi se automjeti i përmbush kushtet e parapara teknike për pjesmarrje në qarkullim në trafikun rrugor.
Mbështetur në këtë Udhëzim Administrativ Ministria Infrastrukturës njofton të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të ofrojnë shërbimin në fjalë dhe të aplikojnë për marrjen e dokumentacionit – specifikacionin teknik të tiketës ngjitëse dhe kriterëve përkatëse për shërbim. Materjalin në fjalë merrret qdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 14:00 në Ministrinë e Infrastrukturës, Departamentin Automjeteve zyra nr. C308, kati III sheshi Nëna Terezë ish ndërtesa e Gërmis në Prishtinë.
Afati për tërheqjen e dokumentacionit është 15 (pesëmbdhjet) ditë nga dita e publikimit në mjetet e infomimit.
Dokumentacioni i kompletuar në original dhe një kopje e noterizuar dorëzohet qdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 15:00 në arkivin e Ministrisë së Infrastrukturës.

Pas përfundimit të afatit për aplikim kërkesat e pranuar do të shqyrtohen nga komisioni I caktuar nga Ministria Infrastrukturës i cili rekomandon dhënjën e Autorizimit siç është e përcaktuar me aktet ligjore.
Ofertat që dorëzohen pas këtij afati nuk do të mirren në shqyrtim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E ARSIMIT
UPRAVA ZA OBRAZOVANJE
DEPARTMENT OF EDUCATION

Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

	17.09. 2018
NR/BR.	1466
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për edukator/e.
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Labjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs për edukator/e.


Mbështetur në nenin 8, të Ligjit të Punës, neni 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT, it nr.10/2018 dhe 05/2015. Normativi për Kuadrin e Arsimit të përgjithshëm dhe arsimin profesional të MASHT, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS

Për Edukator/e

1. Në SHFMU "Besim Rexhepi" në Komogllavë:
- Një edukatore.
2. Në SHFMU " Dëshmorët e Lirisë" në Manastirc:
-Një edukatore,

Kushtet: Për vendet e punës për edukator/e kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimeve Administrativ të MASHT- Normativi për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. **Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit. Kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë për vendet e lartshënuara duhet të dorëzojnë kërkesën me dokumentacionin e kompletuar në vijim:
-Diplomën, ose Çertifikatën e diplomës së fakultetit, kopje e vërtetuar,
-Çertifikatën- ose ekstraktin e lindjes,
-Letërnjoftimi kopje,
Kohëzgjatja e Kontratës së punës fillon prej datës së fillimit të punës deri më 31.08.2019.
Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.
Dokumentet nuk kthehen.
Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit, në tabelën e shpalljeve, në web faqen e Komunitet dhe në njërin nga mjetet e shkruara të informimit, duke filluar prej datës **18.09.2018, deri më 02.10.2018.**
DA – Ferizaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

DEPARTAMENTI I AUTOMJETEVE / ODJEL ZA VOZILA / DEPARTMENT OF VEHICLE

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi qe ka Ministria Infrastrukturës mbështetur, në Udhëzim Administrativ 01/2018 për Kontrolla Teknike në nenin 3 pika 6 e këtij Udhëzim Administrativ shpall këtë:

Njoftim

Njoftohen të gjitha palët e interesuara për ofrimin e shërbimit me "Tiket ngjitëse" për automjete të cilat i nënshtrohen kontrollimit teknik.
Tiketa do të shërbej si dëshmi se automjeti i përmbush kushtet e parapara teknike për pjesmarrje në qarkullim në trafikun rrugor.
Mbështetur në këtë Udhëzim Administrativ Ministria Infrastrukturës njofton të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të ofrojnë shërbimin në fjalë dhe të aplikojnë për marrjen e dokumentacionit – specifikacionin teknik të tiketës ngjitëse dhe kriterëve përkatëse për shërbim. Materjalin në fjalë merrret qdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 14:00 në Ministrinë e Infrastrukturës, Departamentin Automjeteve zyra nr. C308, kati III sheshi Nëna Terezë ish ndërtesa e Gërmis në Prishtinë.
Afati për tërheqjen e dokumentacionit është 15 (pesëmbdhjet) ditë nga dita e publikimit në mjetet e infomimit.
Dokumentacioni i kompletuar në original dhe një kopje e noterizuar dorëzohet qdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 15:00 në arkivin e Ministrisë së Infrastrukturës.

Pas përfundimit të afatit për aplikim kërkesat e pranuar do të shqyrtohen nga komisioni I caktuar nga Ministria Infrastrukturës i cili rekomandon dhënjën e Autorizimit siç është e përcaktuar me aktet ligjore.
Ofertat që dorëzohen pas këtij afati nuk do të mirren në shqyrtim.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Migjeni"

Komuna: Skenderaj

Data: 19.09.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/118 - ESIP/SDG/118-CS/1.2	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Migjeni" Kllodernicë, Skenderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Përshkrimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
 - Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
- Kriteret minimale për kualifikim të Firmave Konsulente që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Migjeni" Kllodernicë, Skenderaj, më së largu deri më 27.09.2018.
- Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë. Firmat Konsulente luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Abedin Abazi

Telefoni: 044/823-798

E-maili: abedini028@live.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Drenica"

Komuna: Skenderaj

Data: 19.09.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/107 - ESIP/SDG/107-CS/1.1	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Drenica" Polac, Skenderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Përshkrimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:
 - Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie
- Kriteret minimale për kualifikim të Firmave Konsulente që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Drenica" Polac, Skenderaj, më së largu deri më 27.09.2018.
